

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUTIT TË STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI PËR VITIN 2020

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në grumbullimin, administrimin, ruajtjen dhe dokumentimin e materialeve të kësaj periudhe në Shqipëri;

Duke njohur bashkëpunimin e këtij Instituti me institucionet kërkimore, kulturore, arsimore dhe institucione të tjera vendase e të huaja për shkëmbimin e informacionit e të përvojës, lidhur me objektin e punës së Institutit;

Duke konsideruar se detyrat kryesore të punës së këtij Instituti kërkojnë mbështetjen e vazhdueshme të organeve shtetërore, medias, shoqërisë civile dhe partnerëve, në funksion të ruajtjes së kujtesës tonë kolektive,

Vlerëson veprimtarinë e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, gjatë vitit 2020, në këto drejtime:

- Informimin publik për krimet e komunizmit përmes rikrijimit të trashëgimisë materiale të komunizmit përmes projekteve digjitale;
- Rritjen e veprimtarisë në sektorin e edukimit shkollor të të gjitha niveleve, me gjetjen e formave sa më interaktive të përcjelljes së historisë së komunizmit, për një impakt sa më të fuqishëm tek të rinjtë;
- Sensibilizimin publik dhe institucional për trashëgiminë materiale të periudhës komuniste dhe rëndësinë e saj, si dhe vitalizimin e kësaj trashëgimie përmes dokumentimit filmik dhe ekspozitave;
- Evidentimin e rasteve të reja të persekutimit, dënimeve me burg dhe internim përmes zgjerimit të databazës dhe numrit të ri të Fjalorit Enciklopedik të Viktimave të Komunizmit;
- Vazhdimësinë e projekteve afatgjata, në lidhje me kërkimin arkivor dhe dëshmitë verbale, siç është pasurimi i databazës dhe arkiva e video-regjistrimeve;
- Ndërkombëtarizimin e historisë së komunizmit në Shqipëri, përmes projekteve ndërkombëtare të bashkëpunimit, si pjesë e rrjetit të Platformës Europiane të Kujtesës.

Kuvendi kërkon që Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, për vitin 2021, të angazhohet në këto drejtime:

1. Të aplikojë forma inovative të pasqyrit të veprimtarisë së Institutit brenda vendit, si dhe jashtë tij, si pjesë e rrjetit të institucioneve të Platformës Europiane të Kujtesës.
2. Të rrisë numrin e botimeve të reja nga transkriptimi i arkivës audio-vizuale të ISKK-së.
3. Të rrisë volumnin e prodhimeve digjitale duke mundësuar sa më shumë aksesim *online* të materialeve që ISKK-ja prodhon.
4. Të hartojë menjëherë një plan strategjik për veprimtarinë e ISKK-së, për caktimin e prioriteteve dhe objektivave afatgjatë, e më pas detajimin në një plan konkret veprimi.
5. Të rinovojë marrëveshjen me ministrinë përgjegjëse për arsimin, me qëllim rritjen e aksesit në sektorin e edukimit shkollor për përfshirjen në planet dhe programet mësimore të shkollave të të gjitha niveleve të informacionit të mjaftueshëm, për krimet e komunizmit dhe të pasojave të tij në Shqipëri.
6. Të intensifikojë bashkëpunimin me institucione homologe të huaja, me qëllim përthithjen e eksperiencave më të mira nga veprimtaria e tyre.
7. Të hartojë Kodin Etik dhe Rregullat e Sjelljes për institucionin.
8. Në funksion të transparencës dhe informimit, të bëjë publike në faqen *online* të institucionit, si dhe në raportin vjetor që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë të gjithë procedurën e rekrutimit të Këshillit Shkencor dhe veprimtarinë e tij, si dhe formularët e vetëdeklarimit të personave që

janë pjesë e organeve drejtuese të institucionit, në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 7.7.2021.